



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Jolix” Sh.P.K. e datës 09.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “20 Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit 616-24-5525-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Jolix” Sh.P.K. e datës 09.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “20 Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit 616-24-5525-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 04.07.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Jolix” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 09.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “20 Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit 616-24-5525-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se në ofertën e tij nuk ka prezantuar katalogje apo broshura për ofertën teknike, apo ndonjë dokument tjetër përmes të cilit dëshmohet se me çfarë sistemi i njëjti ka ofertuar. Pra OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk ka prezantuar dokumente konkrete që dëshmojnë se si dhe çfarë janë specifikat e produktit të tyre. Kur analizohen specifikimet teknike tek aneksi 1 i dosjes së tenderit, shihet qartë se të njëjtat janë të detajuara për të gjitha aspektet e sistemit të kërkuar të transkriptimit, respektivisht shërbimet e transkriptimit të audiove në gjuhën shqipe, furnizimi me pajisje të teknologjisë informative sipas përshkrimit teknik dhe sistemi për menaxhimin e detyrave dhe projekteve, andaj edhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të prezantoj dëshmi konkrete se produktet e të njëjtit janë konform të gjitha specifikimeve teknike të aneksit 1. Në hyrje të qellimit të prokurimit AK ka potencuar se meton të perdore platforme softuerike dhe procesuese të inteligjencës artificiale. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar as me liste të projekteve të realizuara se posedon pervojë me inteligjencë artificiale dhe poashtu nuk ka potencuar e as specifikuar platformen të cilën e vë në shërbim sipas specifikimeve të detyrueshme të AK-së në Aneksin 1 e atë me pak dëshmi nëse ajo i plotëson specifikimet e detyrueshme të AK-së. Duhet cekur fakti se tek specifikimet teknike janë specifikuar disa kritere kyçe për produktin e kërkuar, ku specifikohen edhe kriteret funksionale të sistemit dhe mundësitë minimale të sistemit të ofruar dhe gjithashtu janë kërkuar edhe kërkesat operative dhe të implementimit, andaj për të vërtetuar se produkti i OE të rekomanduar për kontratë i plotëson këto specifika, i njëjti është dashur të prezantoj dëshmi konkrete për të vërtetuar si njëjti i përmbush këto kërkesa minimale për funksionimin e sistemit. Asnjë dëshmi a dokument nuk është dorëzuar me oferte, që AK të mund të bejë vlerësimin e ofertes në aspektin teknik. Po ashtu tek specifikimet teknike janë përshkruar edhe karakteristikat kryesore dhe funksionale të sistemit; Kontrolli dhe konfigurimi i avancuar; Ndërlidhja dhe integrimi; Regjistrimi dhe monitorimi, etj., andaj edhe këto specifika është dashur të dëshmojnë me dokumente konkrete, e që një gjë të tillë OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka bërë. I njëjti në ofertë ka prezantuar vetëm një deklaratë mbi specifikimet teknike, mirëpo e njëjta nuk tregon ASGJË në lidhje me specifikat e produkteve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues. Andaj, përderisa i njëjti nuk ka ofruar ndonjë dokument konkret në lidhje me specifikimet teknike, kuptohet qartë se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e autoritetit kontraktues. Oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk përputhet edhe me nenin 69 paragrafi 2.2 dhe 2.4 sepse nuk ka asnjë përshkrim të pajisjeve dhe specifikimeve teknike e as mostra, e as ndonjë fotografi për produkte dhe specifikimet teknike. Sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik kur Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu duhet refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”.

Lidhur me pretendimet ankimore, duhet theksuar faktin se specifikat teknik të këtij aktiviteti të prokurimit janë kërkesa kryesore e dosjes së tenderit për shkak të natyrës së aktivitetit të prokurimit. Ky fakt nuk është kontestues pa çka se mund të konfirmohet lehtësisht vetëm nëse analizohet volumi dhe kompleksiteti i specifikave teknike të përcaktuara sipas aneksit 1 të dosjes së tenderit. Në anën tjetër tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar një deklaratë për përmbushjen e specifikave mirëpo në deklaratë nuk ka argumentuar se në cilën formë (me cilin sistem, metodë dhe/apo pajisje) do të arrij që të përmbushë të gjitha këto specifika pa përjashtim. Njëkohësisht nuk ka bashkangjitur as ndonjë dokument mbështetës (katalog, broshurë apo të ngjashme) për të dëshmuar pranë autoritetit kontraktues përmbushjen e specifikave teknike sipas deklaratës përkatëse.

Me qëllim që të sigurohet realizimi me sukses i kontratës që synohet të lidhet me këtë aktivitet të prokurimit, është e domosdoshme që para lidhjes së kontratës AK të sigurohet që tenderuesi i rekomanduar për kontratës do të ketë cilësitë e nevojshme për realizimin e kontratës sipas specifikave teknike të kërkuara nga AK. Për këto arsye komisioni vlerësues është dashur që të kërkoj sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar mbi përmbushjen e specifikave teknike duke marrë parasysh të thënat si më sipër. Prandaj pretendimi ankimor i parashtruesit është i bazuar pjesërisht.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 15.07.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.